

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR " SARANDA REAL ESTATE GROUP" Sh.p.k.

Sot më datë 11.11.2019, une shtetasi Z. **ROMEO DHIMO**, atesia Vangjel, i datelindjes 13.08.1970, lindur dhe banues ne Sarande, identifikuar nepermjet pasaportes me nr. Personal H00813061I, me zotesi te plote per te vepruar, kam vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e kësaj kontrate, së cilës i bashkëngjitet (më poshtë "Shtojca 1").

Neni 1 - Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është " SARANDA REAL ESTATE GROUP" Sh.p.k.

Neni 2 - Selia

4.3. Selia e Shoqërisë është në adresen: *Vlore, Sarande, lagjia nr.5, rruga nacionale Sarande- Butrint, km 1, perballe "Hotel Grandi".*

Neni 3 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë për një afat te pacaktuar.

Neni 4 - Objekti i shoqërisë

Shoqëria ka për objekt:

- Ndertime civile dhe ekonomike. Investim dhe sipermarrje ne fushen e ndertimit.
- Shitje- blerje, dhenie me qira te apartamenteve, njesive pasurive te paluajteshme.
- Hapje dhe shfrytezim hotelesh, qendra fitnesi, qendra masazhi.
- Te ofroje kryeje dhe drejtoje sherbime sipermarrje dhe veprimtari te te gjitha llojeve, ne lidhje dhe ne dobi te bashkepunimit, tregtise, biznesit, agjensi turistike, transport detar dhe tokesor, ndermjetesimit, marketingut.

Neni 5 - Kapitali themeltar

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë) lekë, I cili eshte I gjithi I shlyer.



- 5.2. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 kuote, me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Neni 6 - Kontributet

- 6.1. Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar nga Ortaku i Vetëm. Ky kontribut është një kontribut në para i barabartë me 100.000 (njëqindmijë) Leke.
- 6.2. Sipas kontributit të mësipërm Ortaku i Vetëm i shoqërisë, gëzon kuotat e kapitalit në masën 100%.

Neni 7 - Transferimi i pjesëve të kapitalit

Pjesët e kapitalit i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8 - Administratori

- 8.1 Me këtë akt emërohet Administrator i Vetëm i Shoqërisë, për një periudhë prej 5 vite nga data e emërimit, shtetasi shqiptar: **ROMEO DHIMO**, atesia Vangjel, i datelindjes 13.08.1970, lindur dhe banues në Sarandë, mbajtes i pasaportës me nr. Personal H008130611, me zotësi të plotë për të vepruar, i cili ka të drejtë të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm apo të jashtëzakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
- 8.2 Administratorit të Vetëm i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori i Vetëm, mund t'i drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund t'i delegojë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit të sipërpërmendur.
- 8.3 Administratori i Vetëm është gjithashtu i autorizuar të veprjë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit(QKR). Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosë të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj pranë QKR si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë

ORTAKU THEMELUES

Romeo Dhimo



Sarandë, më 11.11.2019